



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

11/3791/2020

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONE

Njoftohen të gjithë fermerët-et se thirrja për aplikim për subvencionim nga komuna e Hanit të Elezit, gjegjësisht nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2020.

Subvencionimi bëhet në këto sektore:

1. Subvencionim për fermerët që kanë të mbjellur kultura në serra mbi 4 ari nga 30€ për ari.
2. Subvencionim për fermerët që kanë të mbjellura sipërfaqe me mjedra mbi 10ari 5€ për ari.
3. Subvencionim për fermerët që kanë të mbjellura sipërfaqe me lule shtrydhe- (dredhëza) mbi 10ari 5€ për ari.
4. Subvencionim për OJQ që merren me veprimtari bujqësore (shoqata bujqësore, shoqata të bletarëve etj.) vetëm përmes shoqatës jo individualisht.
5. Subvencionim për fermerët që kanë të mbjellura mbi 20 ari sipërfaqe me grurë.

Dokumentacionet e nevojshme për aplikim:

- Letërnjoftimi i,e aplikuesit/aplikueses -kopje ose Pasaporta -kopje
- Konfirmimi i Xhirollogarisë Bankare
- Vërtetimi i tatimit në pronë (dëshmia e pagesës)
- Dëshmia kadastrale e sipërfaqes së mbjellur në serra dhe sipërfaqe të hapura (mjedra dhe luleshtrydhe –dredhëza dhe grurë)
- Dokumentacionet e Shoqatës (Numri biznesit,numri fiskal,xhirollogaria bankare si dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar të shoqatës)

Kriteret për subvencionim :

- Duhet të jetë banor-e i,e Hanit të Elezit
- Sipërfaqja e tokës duhet të jetë në territorin e komunës tonë
- Parcelat e mbjellura duhet të jenë minimum 0.10 ha me mjedra dhe dredhëza
- Dëshmia e kryerjes së obligimeve të shoqatave (shoqatave bujqësore,shoqatës së bletarëve etj.)

Afati për aplikim është nga 07.07.2020 deri me 24.07.2020 ora 15:00
Aplikacionet dorëzohen në zyrën e pritjes së komunës –Qendra për shërbim të qytetarëve.

Me respekt,

